



Buletini mujor

Korrik 2026



Miratohet Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2025”

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancën plenare të datës 23 korrik 2026 Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2025”.

Rezoluta përmban vlerësimet dhe rekomandimet e Kuvendit për veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), me synim forcimin e llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike, si dhe përmirësimin e administrimit të fondeve dhe pasurive publike, në shërbim të interesit publik dhe mirëqeverisjes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbetet i përkushtuar për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, si pjesë e një procesi të vazhdueshëm për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë audituese dhe forcimin e bashkëpunimit institucional.

Miratimi i rezolutës u mbështet në raportimet e Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, ku u paraqit “Raporti vjetor i veprimtarisë për vitin 2025”, si dhe në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

Gjatë shqyrtimit të projektrezolutës në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, më 8 korrik 2026, Kryetari i KLSH-së paraqiti masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit lidhur me përditësimin e metodologjisë së auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare, auditimin e kontratave koncesionare dhe partneriteteve publik-private, zgjerimin e fushës së auditimeve të performancës dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe.

Gjatë vitit 2025, KLSH ka zhvilluar 190 auditime në 271 subjekte. Auditimet kanë konkluduar me dhënien e 4994 rekomandimeve, të cilat përfshijnë propozime për përmirësime të kuadrit ligjor, masa organizative, masa për shpërblim dëmi, masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar dhe masa disiplinore dhe administrative.

Në lidhje me auditimin e kontratave koncesionare me rëndësi të veçantë për interesin publik, z. Shehu bëri të ditur se KLSH po zhvillon auditime për projektin rrugor Thumanë-Fushë-Krujë-Vorë-Kashar, shërbimin mjekësor “Check-up” dhe shërbimet e integruara në sallat kirurgjikale.

Në fushën e auditimeve të performancës, z. Shehu theksoi se gjatë vitit 2025 u trajtuan çështje me ndikim të drejtpërdrejtë për qytetarët, si ndotja e ujërave, mbrojtja dhe siguria e digave, si dhe masat për reduktimin e varfërisë në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Programi i auditimeve të performancës për vitin 2026 është zgjeruar me fusha të reja, si veprimtaria e hidrocentraleve, sistemet fotovoltaike, kontrolli i cilësisë së drithërave dhe efektiviteti i komisioneve të KEMP-it. Gjithashtu, programi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit përfshin një numër më të madh auditimesh krahasuar me vitet e mëparshme.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, KLSH aktualisht është angazhuar në disa auditime të përbashkëta dhe paralele me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, SAI-n e Maqedonisë së Veriut, SAI-n e Ukrainës; SAI-n e Norvegjisë, si dhe në aktivitetet e EUROSAI-t përmes grupeve të tij të punës.

Dëgjesa në Nënkomision mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit “Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri”

Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik zhvilloi më 14.07.2026 një dëgjese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të KLSH-së “Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri”.

Në mbledhje ishin të ftuar për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve dhe për të informuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, zëvendësministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Eugena Tomini, drejtori i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, z. Erjon Spahiu etj. Nga KLSH ishin të pranishëm në mbledhje znj. Arminda Bushi, znj. Xhuljeta Çelaj, z. Klarenc Xhaferaj dhe znj. Ina Sokoli.

Gjatë dëgjesës, përfaqësuesit e MSHMS-së dhe AKBPM-së iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve mbi disa çështje të evidentuara edhe në auditim, ndër të cilat: numri i barnave të autorizuara dhe i barnave të testuara fizikisht në laborator; bashkëpunimi i Agjencisë me EMA-n dhe FDA-n; disponueshmëria e barnave dhe besueshmëria e tregut farmaceutik; testimi laboratorik i barnave të importuara me autorizim të posaçëm; mungesa e barnave të alternativës së parë në listën e rimbursimit; çmimi i barnave në vende, pajisjet mjekësore në Spitalin Onkologjik etj.



Në përfundim të dëgjesës, kryetari i Nënkomisionit, z. Igli Cara, bëri të ditur se në mbledhjen e radhës do të paraqitet raporti i Nënkomisionit, i cili do të përmbajë rekomandimet përkatëse drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

SESION PUNE KLSH - NËNKOMISIONI PËR AUDITIMIN E SEKTORIT PUBLIK

Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare përmes shqyrtimit efektiv të rekomandimeve të KLSH-së



Më 22 korrik 2026 u zhvillua në ambientet e Hotel Rogner, Tiranë, sesioni i punës i Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Aktiviteti u organizua me mbështetjen e Institutit Demokratik Amerikan (National Democratic Institute – NDI) dhe kishte në fokus forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit përmes shqyrtimit efektiv të raporteve të auditimit të KLSH-së dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të tyre, me synim rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike.

Në takim morën pjesë anëtarë të Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, deputetë të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, përfaqësues nga KLSH, SECO, SIGMA, NDI etj.

Gjatë punimeve u shqyrtuan gjetjet dhe rekomandimet e dy raporteve të auditimit të përzgjedhura nga Nënkomisioni, të cilat trajtojnë çështje me interes të lartë publik:

“Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë” dhe “Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirëritje dhe edukim”.

Diskutimet u përqendruan në identifikimin e çështjeve prioritare për mbikëqyrjen parlamentare, organizimin e seancave dëgjimore parlamentare dhe krijimin e mekanizmave të monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.


Aktiviteti përbën një hap konkret drejt krijimit të një praktike më të qëndrueshme bashkëpunimi ndërmjet KLSH-së dhe Kuvendit, me synim përdorimin më efektiv të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit në funksion të forcimit të mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve publike.

RULE of LAW

Report 2026



#RuleOfLaw



RAPORTI 2026 PËR “SUNDIMIN E LIGJIT”

Komisioni Evropian vlerëson KLSH për bashkëpunimin në luftën kundër korrupsionit

Komisioni Evropian ka publikuar më 17 korrik 2026 “Raportin për Sundimin e Ligjit” (Rule of Law), në të cilin vlerësohet kontributi i Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftën kundër korrupsionit. Raporti evidenton se KLSH ka vijuar praktikën e referimeve për ndjekje penale dhe bashkëpunimin me organet e Prokurorisë.

“KLSH vijoi praktikën e referimeve për ndjekje penale dhe bashkëpunimin me organet e Prokurorisë. Gjatë vitit 2025, KLSH referoi pranë organeve të Prokurorisë 8 raste me elementë të dyshuar penalë. Gjithashtu, vijoi shkëmbimi i informacionit me kërkesë të autoriteteve të Prokurorisë. Gjatë vitit 2025, pranë këtyre organeve u dërguan, me kërkesë të tyre, 43 materiale lidhur me çështje që kërkonin verifikim ose hetim të mëtejshëm”, thuhet në Raportin e vitit 2026 për “Sundimin e Ligjit”.

Komisioni Evropian ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme rolin e KLSH-së në forcimin e llogaridhënies institucionale, parandalimin e korrupsionit dhe kontributin e tij në procesin e integritetit evropian.

Në Raportin e Progresit “Shqipëria 2025”, evidentohet cilësia e punës audituese të KLSH-së në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe theksohet nevoja për përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Raporti i Komisionit Evropian “Sundimi i Ligjit” 2025 për KLSH

“KLSH vijoi praktikën e referimeve për ndjekje penale dhe bashkëpunimin me organet e Prokurorisë. Gjatë vitit 2025, KLSH referoi pranë organeve të Prokurorisë 8 raste me elementë të dyshuar penalë. Gjithashtu, vijoi shkëmbimi i informacionit me kërkesë të autoriteteve të Prokurorisë. Gjatë vitit 2025, pranë këtyre organeve u dërguan, me kërkesë të tyre, 43 materiale lidhur me çështje që kërkonin verifikim ose hetim të mëtejshëm.

The State Audit Institution (ALSAI) maintained its track record on judicial referrals and cooperation with criminal prosecution bodies. In 2025, ALSAI referred eight cases with criminal elements to prosecution.

Additionally, there was continued information sharing at the request of prosecution authorities (43 materials on issues requiring further investigation were shared with prosecutorial bodies upon request in 2025).

”

Auditimi mbi “Efektivitetin e masave të ndërmarra për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format”

Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH kreu auditimin me temë “Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ-ve: ‘Zhdukja e varfërisë në të gjitha format’”. Auditimi u zhvillua në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Institutin e Statistikave, si dhe në bashkitë Durrës dhe Elbasan. Periudha e auditimit përfshiu vitet 2022–2024. Auditimi kishte si objektiv vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe masave të ndërmarra për përmbushjen e Objektivit 1 të OZHQ-ve, që synon zhdukjen e varfërisë në të gjitha format e saj.

Nga auditimi rezultoi se, megjithëse Shqipëria ka integruar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në dokumentet strategjike dhe ka ndërmarrë politika për zbutjen e varfërisë, ende mungojnë elementë bazë për hartimin dhe zbatimin efektiv të këtyre politikave. Në veçanti, vendi nuk ka një përkufizim zyrtar të varfërisë dhe nuk ka miratuar ende një minimum jetik, çka kufizon efektivitetin e skemave të ndihmës ekonomike, programeve të mbrojtjes sociale dhe matjes së varfërisë.

Auditimi evidentoi se në periudhën 2016–2024 janë financuar rreth 4.12 trilionë lekë për përmbushjen e OZHQ-ve, ndërsa fondet për Objektivin 1 – “Zhdukja e varfërisë” janë rritur nga rreth 60 miliardë lekë në vitin 2016 në rreth 100 miliardë lekë në vitin 2024. Megjithatë, pavarësisht rritjes së financimit, mbi 40% e popullsisë në Shqipëri vijon të jetë në rrezik varfërie ose përjashtimi social, nivel rreth dy herë më i lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian (21% e popullatës në vitin 2023). Ndërkohë, edhe buxheti i alokuar për mbrojtjen sociale në vendin tonë është ndjeshëm më i ulët, se mesatarja e vendeve të BE-së. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë vitit 2023 kanë përfituar ndihmë ekonomike mesatarisht 62 mijë familje.

Raporti i monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale evidenton se vetëm 62% e popullsisë në varfëri ekstreme përfiton ndihmë ekonomike, kundrejt objektivit prej 100%, ndërsa vetëm 65% e familjeve përfituese janë përfshirë edhe në programe të tjera mbështetëse, kundrejt objektivit prej 75% deri në vitin 2023.

Gjithashtu, auditimi konstatoi se shpenzimet për mbrojtjen sociale në vitin 2024 përbënin rreth 9% të PBB-së ose 31% të shpenzimeve totale qeveritare, pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2013. Buxheti për mbrojtjen sociale mbetet më pak se gjysma e mesatares së Bashkimit Evropian, ndërsa shpenzimet për shërbimet thelbësore (mbrojtjen sociale, arsimin dhe shëndetësinë) për periudhën 2013–2024 përfaqësojnë rreth 50% të shpenzimeve qeveritare, krahasuar me mesataren prej 65% në vendet evropiane. Në përfundim, auditimi vlerësoi se, megjithëse janë ndërmarrë masa dhe është rritur financimi për zbutjen e varfërisë, rezultatet e arritura mbeten të kufizuara dhe nuk janë në përputhje me objektivat e vendosura. Mungesa e një minimumi jetik të miratuar, niveli i lartë i popullsisë në rrezik varfërie dhe mbulimi jo i plotë i grupeve në nevojë tregojnë se nevojiten masa më efektive për planifikimin, financimin dhe monitorimin e politikave sociale. Për këtë arsye, Kontrolli i Lartë i Shtetit rekomandon që deri në vitin 2027 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe Ministrinë e Financave, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për miratimin e minimumit jetik, i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e politikave të mbrojtjes sociale, përcaktimin e ndihmës ekonomike dhe matjen e varfërisë në vend.




40%

e popullsisë, në rrezik varfërie ose përjashtimi social gjatë periudhës 2022–2024

50%

e shpenzimeve totale, gjatë periudhës 2013–2024, janë alokuar për shërbimet thelbësore

Shpenzimet thelbësore në total dhe të detajuara sipas sektorëve, si % nga shpenzimet totale



Çfarë konsiderohet varfëri?



Sipas standardit ndërkombëtar, varfëria ekstreme nënkupton të jetosh me më pak se 2.16 dollarë amerikanë në ditë. Megjithatë, sipas përkufizimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), varfëria nuk kufizohet vetëm në mungesën e të ardhurave. Ajo përkufizohet si privim i rëndë nga nevojat themelore njerëzore, duke përfshirë aksesin në ushqim, ujë të pijshëm të sigurt, mjedis të pastër, kujdes shëndetësor, strehim, arsim dhe informacion. Pikërisht për këtë arsye, Objektiv 1 i OZHQ-ve synon zhdukjen e varfërisë në të gjitha format e saj, duke e trajtuar atë si një fenomen shumëdimensional dhe jo vetëm si mungesë të ardhurash.

Bashkëpunimi për zhvillim të qëndrueshëm: Qasje inovative nga Institucionet Supreme të Auditimit



Më 8 korrik 2026 u zhvillua aktiviteti paralel i INTOSAI-t, në kuadër të Forumit Politik të Nivelit të Lartë të OKB-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm (HLPF 2026), me temë *"Bashkëpunimi në kuadër të ekosistemit të llogaridhënies për zhvillim të qëndrueshëm – Qasje inovative nga Institucionet Supreme të Auditimit"*.

Aktiviteti u organizua nga Kryesia e INTOSAI-t (SAI i Egjiptit), Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t (SAI i Austrisë), Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI-t (IDI) dhe Misioni i Përhershëm i Egjiptit pranë Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në bashkëpunim me Departamentin e Çështjeve Ekonomike dhe Sociale Kombeve të Bashkuara (UN DESA). Takimi u zhvillua në format hibrid, me pjesëmarrje fizike në ambientet e Misionit të Përhershëm të Egjiptit pranë OKB-së në Nju Jork dhe me transmetim online në platformën "Zoom". Nga KLSH, aktiviteti u ndoq online nga znj. Miranda Misini dhe znj. Vjola Kojani, audituese në Departamentin e Auditimit të Performancës.

Aktiviteti u hap me fjalët përshëndetëse të znj. Manal Mohamed Khairy, Zëvendësprezidentë e Autoritetit Shtetëror të Llogaridhënies të Egjiptit dhe përfaqësuese e Kryesisë së INTOSAI-t, përfaqësuesve të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, si dhe ambasadorit Ihab Awad, Përfaqësues i Përhershëm i Egjiptit pranë Kombeve të Bashkuara. Ata theksuan rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit jo vetëm në mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve publike, por edhe si partnerë të rëndësishëm për forcimin e llogaridhënies dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në një botë që po ndryshon me ritme të shpejta.

Ndër çështjet kryesore të trajtuara gjatë aktivitetit ishin:

- Forcimi i kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit për auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Bashkëpunimi ndërmjet INTOSAI-t, IDI-t dhe UN DESA-s për zhvillimin e iniciativës "Audituesit e OZHQ-ve në Institucionet Supreme të Auditimit", me synim rritjen e kompetencave profesionale të audituesve.
- Forcimi i ekosistemeve fiskale si një element kyç për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Tendencat e reja që ndikojnë në realizimin e Agjendës 2030.
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale dhe i teknologjive inovative në proceset e auditimit të OZHQ-ve.

Në panelin e parë, përfaqësues të IDI-t dhe UN DESA-s prezantuan iniciativën *"Audituesit e OZHQ-ve në Institucionet Supreme të Auditimit"*, e cila synon zhvillimin e aftësive profesionale të audituesve për auditimin e zbatimit të OZHQ-ve. Gjithashtu, u paraqitën gjetjet kryesore të Raportit Botëror mbi Sektorin Publik 2025, me fokus ndërtimin e institucioneve publike të forta, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në panelin e dytë u diskutuan qasje inovative për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit, organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve të tjerë të ekosistemit të llogaridhënies. Gjatë diskutimeve u evidentua rëndësia e krijimit të sinergjive ndërmjet auditimit të OZHQ-ve dhe auditimit të raportimit të qëndrueshmërisë në sektorin publik, forcimit të sistemeve fiskale, si dhe integritit të Inteligjencës Artificiale dhe teknologjive të avancuara në proceset e auditimit, me qëllim rritjen e cilësisë, efikasitetit dhe ndikimit të tyre.

Në përfundim të aktivitetit, përfaqësuesit e IDI-t riafirmuan angazhimin e INTOSAI-t dhe partnerëve të saj për të vijuar zhvillimin e iniciativave të përbashkëta që mbështesin rritjen e kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe përdorimin e qasjeve inovative në auditimin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Falënderit për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	   Kontrolli i Lartë i Shtetit klsh_org_al (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00